



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:053960

Datë: 09.08.2024

Numri i dokumentit: 06038017

**C.nr. 304/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN** – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, duke vendosur në procedurën kontestimore sipas padisë së paditësit B.H nga ...-Komuna e Gjilanit, të cilin e përfaqëson Bashkim Ilijazi nga Gjilani, kundër të paditurve H, N, S dhe D, të gjithë H nga fshati ....-Komuna e Gjilanit, për vërtetimin e pronësisë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 09.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.** Ndërprehet procedura kontestimore sipas padisë së paditësit B.H nga ...-Komuna e Gjilanit, kundër të paditurve H N, S dhe D, të gjithë H nga fshati ....-Komuna e Gjilanit, për vërtetimin e pronësisë,

**II.** Procedura e ndërprerë do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

**A r s y e t i m**

Paditësi B.H nga ...-Komuna e Gjilanit, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim Bashkim Ilijazi nga Gjilani, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurve H N, S dhe D, të gjithë H nga fshati ....-Komuna e Gjilanit, për vërtetimin e pronësisë.

Gjykata, duke ndërruar veprime procedurale, palëve të paditura N H, S H dhe D H, ju ka dërguar aktvendimin për përgjegjëje në padi, por nga fletëkthesat e kthyera konstatohet se të njëjtit janë të vdekur.

Andaj, gjykata ka marrur aktvendim për ndërprerjen e procedurës konform nenit 277 pika a) të LPK-së, në të cilën dispozitë është përcaktuar se ‘ ‘ *Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim;* Nga të cekurat më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2022:053960, 09.08.2024**

**G j y q t a r i,**  
**Berat Spahiu**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda afatin prej 15 ditësh pas dites se pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes Gjykatës Themelore në Gjilan .